



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 812 Prot

Tiranë, më 06.06.2016

Nr. 706 Dosje

## VENDIM

### PËR PUSHIMIN E EKZEKUTIMIT

Unë, Altin Vako, me detyrën e Përmaruesit Gjyqësor, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 10041/U, të lëshuar në datë 20.10.2014 lëshuar prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë urdher, duke regjistruar në dosjen përmarimore, Nr. 706, datë 10.05.2016, kërkesën e kreditorit, Z. Gentjan Varosi, ndaj debitorëve “Banka Kombëtare e Greqisë” Sh.a., (sot “Banka NBG Albania” Sh.a.), dhe Shoqërisë “TDR Group” Sh.p.k., në lidhje me titullin ekzekutiv – Vendim Nr. 10041, datë 20.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me Vendimin Nr. 532, datë 10.03.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Pasi fillova ekzekutimin e detyrueshëm duke i dërguar debitorit lajmërimin Nr. 688 Prot, date 10.05.2016 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin, kam kaluar në vënien e sekuestros konservative tek kreditë, aksionet dhe asetet e “Banka Kombëtare e Greqisë” Sh.a., (sot “Banka NBG Albania” Sh.a.).

Urdhërat për vendosjen e sekuestrove konservative janë dërguar pranë:

- DRSHTRR Tiranë me shkresën Nr. 760 Prot, datë 24.05.2016
- Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me shkresën Nr. 759 Prot, datë 24.05.2016
- Bankave Nivelit II me shkresën Nr. 761 Prot, datë 24.05.2016

Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet procedurale të nevojshme për ekzekutimin e plotë të titullit ekzekutiv me palët e lartpërmendura,

## KONSTATOJ

Se pala debitore “Banka NBG Albania” sh.a., ka dërguar shkresën Nr. 006899 Prot, datë 03.06.2016 me anë të së cilës informohem se e gjithë shuma e detyrimit ishte derdhur në llogarinë e Përmaruesit Gjyqësor Altin Vako pranë kësaj banke, duke zbatuar plotësisht vendimin e gjykatës.



Në këto kushte, referuar nenit 616 Pika (a) të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 32. Pikat (b,c) të Ligjit Nr. 10031, datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”,

## VENDOSA

1. Pushimin e ekzekutimit të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 10041/U, datë 20.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi detyrimi është shlyer tërësisht.
2. DRSHTRR Tiranë, të bëjë ç’bllokimin e dokumentacionit të mjeteve që mund të ketë në pronësi “Banka Kombëtare e Greqisë” Sh.a., (sot “Banka NBG Albania” Sh.a.), me Nr. NIPT-i: J61911008C, të cilat janë bllokuar me anë të shkresës Nr. 760 Prot, datë 24.05.2016 të Përmbaruesit Gjyqësor Altin Vako.
3. Bankat e Nivelit II të bëjnë ç’bllokimin e depozitave, kredive apo llogarive bankare të “Banka Kombëtare e Greqisë” Sh.a., (sot “Banka NBG Albania” Sh.a.), me Nr. NIPT-i: J61911008C, të bllokuara me anë të shkresës Nr. 761 Prot, datë 24.05.2016 të Përmbaruesit Gjyqësor Altin Vako.
4. Qendra Kombëtare e Regjistrimit të beje ç’bllokimin e aksioneve apo kredive të “Banka Kombëtare e Greqisë” Sh.a., (sot “Banka NBG Albania” Sh.a.), me Nr. NIPT-i: J61911008C, të bllokuara me anë të shkresës Nr. 759 Prot, datë 24.05.2016 të Përmbaruesit Gjyqësor Altin Vako.

Ky vendim mund të ankimohet përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 5-ditësh.

## PËRMBARUES GJYQËSOR

**ALTIN VAKO**

A circular official stamp in blue ink is positioned over a handwritten signature in blue ink. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRIE" at the top, "ALTIN VAKO" in the center, and "PËRMBARUES GJYQËSOR" at the bottom. The signature is a cursive script that overlaps the stamp.